BANKA E SHQIPËRISË

“ASPEKTE TË PERFORMANCAVE TË EKSPORTEVE SHQIPTARE”

Nga : Dr. Selami Xhepa
Argita Frashëri

MATERIAL DISKUTIMI, Nr. 1 (5/01)

Janar 2001

BANKA E SHQIPËRISË, Sheshi "Skënderbej", Nr.1
Tiranë - SHQIPËRI

Tel: 355-4-222152; 222153, 222156

Fax: 355-4-223558

Telex: 2153 BANKA AB.

E-mail: intlrel@boa.tirana.al

Interneti: www.bankofalbania.org

Tirazhi : 550 kopje

Opinionet e shprehura në këtë material diskutimi janë mendime personale të autorëve dhe jo qëndrime zyrtare të Bankës së Shqipërisë, pavarësisht nga pozicionet e tyre. Jeni të lutur të citoni burimin sa herë që i referoheni këtij materiali.

Abstrakt

Duke konsideruar që aktiviteti i tregtisë së jashtme zë një vend të rëndësishëm në jetën ekonomike të vendit, dinamikat dhe zhvillimet e tij mund të jenë domethënëse nga pikëpamja e luhatjeve të ciklit të biznesit. Në këtë kuptim, tregtia e jashtme mund të përdoret si një instrument në kundërbalancimin e luhatjeve ciklike në të cilat kalon ekonomia. A paraqet tregtia e jashtme shqiptare efekte gjeneruese për ekonominë e vendit dhe cili komponent i tij duket më i rëndësishëm?

Aspekt tjetër i rëndësishëm i tregtisë së jashtme është dhe lidhja e këtij aktiviteti me zhvillimet ekonomike që ndodhin në vendet partnere. A shkakton efekte një cikël biznesi në rënie në ekonomitë partnere, në rënien e tregtisë së jashtme të vendit tonë? Në analizë të fundit, a ka ndonjë shkallë të lartë ndikimi i eksternaliteteve në ekonominë shqiptare?

Së fundi, a luan ndonjë rol konkurrencialiteti i treguesve të punës në harmonizimin e ndërveprimit dinamik midis procesit të investimeve dhe zgjerimit të bazës së eksporteve?

Këto përbëjnë çështjet që synon të adresojë materiali në vijim, nëpërmjet një analize më shumë intelektuale se empirike.

P Ë R M B A J T J A

I.	**HYRJE**	**7**
II.	**A JANË BËRË TREGJET E PRODUKTEVE SHQIPTARE MË TË INTEGRUARA SI REZULTAT I LIBERALIZIMIT?**	***10***
1.	**Rëndësia e tregtisë së jashtme për ekonominë kombëtare.**	***10***
2.	**Luhatshmëria e variablave të tregtisë.**	***12***
III.	**PSE EKSPORTET?**	***17***
1	**Ndryshimet strukturore të eksporteve shqiptare gjatë periudhës 1996-1999.**	***18***
2	**Shkalla e specializimit të eksporteve.**	***20***
IV.	**KONKURRENCIALITETI I JASHTËM I EKONOMISË: PAGAT DHE PRODUKTIVITETI**	***22***
V.	**KONKLUZIONE**	***25***
	Bibliografia	***27***

I. HYRJE

Shqipëria filloi liberalizimin e tregtisë së jashtme në gjysmën e dytë të vitit 1992, duke eliminuar, thuajse tërësisht, barrierat tregtare. Një Marrëveshje për Tregtinë dhe Bashkëpunimin Ekonomik ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Europian (BE) u nënshkrua që në vitin 1991, duke i akorduar vendit tonë statusin e vendit më të favorizuar (GSP). Që nga viti 1992, Shqipëria aplikoi për anëtarësimin në Organizatën Botërore të Tregtisë [1] (OBT), sipas Artikullit XII të Marrëveshjes së Themelimit të OBT. Marrëveshja për pranimin e Shqipërisë në këtë organizatë u nënshkrua në 17 korrik 2000, datë në të cilën vendi ynë është zyrtarisht anëtar me të drejta të plota.

Në periudhën 1993-1999 totali i eksporteve shqiptare u rrit me 146.2 për qind, me një rritje mesatare vjetore 19.8 për qind, ndërsa importet u rritën me 56 për qind, me një mesatare vjetore 9.4 për qind. Në fund të vitit 1999 eksportet u ngjitën në 275.1 milionë dollarë, ndërsa importet në 937.9 milionë dollarë.

Tabela 1. Import-Eksporti, në milionë dollarë.

Periudha	Eksporte	Importe
1993	111.7	601.2
1994	141.4	601.0
1995	204.8	679.8
1996	243.7	922.0
1997	158.6	693.5
1998	208.0	811.7
1999	275.1	937.9



Grafiku 1. Import/Eksport, indeks. Viti 1993=100.

[1] OBT përfaqëson procesin më ambicioz të negociatave të zhvilluara në kuadrin e GATT, midis 109 vendeve anëtare (dhe 19 në proces). Implikimet ekonomike të anëtarësimit në OBT janë një çështje mjaft e debatueshme në literaturën ekonomike lidhur me kostot dhe përfitimet. Për disa prej tyre, shih: D. Greenaway, C. Milner, 1995 " *The world trade system and the Uruguay Round*", International Labour Review, vol. 134, nr. 4-5.

Ndryshimi më i rëndësishëm në sistemin e tregtisë së jashtme pas shembjes së sistemit të ekonomisë së komanduar ishte riorientimi i saj drejt vendeve të industrializuara, veçanërisht drejt Bashkimit Europian.



Grafiku 2. Volumi i tregtisë së jashtme me vendet e tjera.

Eksportet shqiptare drejt BE-së, për periudhën 1996-1999 u rritën me 43 për qind duke përbërë 94 për qind të volumit të përgjithshëm.



Grafiku 3. Shpërndarja gjeografike e tregtisë së jashtme.

Me një shifër të tillë, në raport me vendet e tjera të Ballkanit, Shqipëria shënon shkallën më të lartë të lidhjes me Bashkimin Europian. Pra, gjeografia e tregtisë së jashtme paraqitet tepër e përqëndruar me këtë rajon, ndërsa gjeografia e tregtisë së jashtme të vendeve të tjera të rajonit është më e diversifikuar.

Qëllimi i këtij materiali është: të japë një shpjegim mbi (i) kuptimin e lidhjeve midis aktivitetit të tregtisë së jashtme dhe ekonomisë kombëtare; (ii) të hedhë dritë për shkallën e lidhjes dhe varësisë së tregtisë së jashtme të vendit tonë me ekonomitë (ciklet e biznesit) e vendeve kryesore partnere dhe (iii) të japë disa argumente shtesë për rëndësinë e eksporteve për ekonominë e

vendit tonë dhe zhvillon në këtë drejtim një kuadër më të thelluar të shkallës së konkurrencialitetit të ekonomisë së vendit tonë në raport me ekonomitë e vendeve të Ballkanit.

Kontributi i këtij materiali qëndron dhe në faktin se, për herë të parë, kemi bërë llogaritjen e disa treguesve të rëndësishëm për analiza ekonomike, të tilla si, nivelin e specializimit të eksporteve, treguesve të produktivitetit, etj..

Të metat e punimit qëndrojnë në faktin se matja e shkallës së ndikimit të sektorit të jashtëm të ekonomisë (eksternaliteteve) është bazuar vetëm në treguesit e ekonomisë italiane. Kjo për faktin se të dhënat e shfrytëzuara janë bazuar në seritë kohore me frekuencë tremujore (të marra nga IFS) ndërkohë që për Greqinë të dhënat ofrohen vetëm në seri vjetore. Megjithatë, përfshirja vetëm e Italisë mbetet përsëri një fakt i rëndësishëm pasi vetëm ky vend përfaqëson më shumë se gjysmën e aktivitetit tregtar të vendit tonë.

Llogaritjet e treguesve të konkurrencialitetit bazohen në të dhënat e marra nga buletinet e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, të cilat ofrojnë informacion vetëm për sektorin shtetëror të ekonomisë. Për rrjedhojë, mbetet pa u analizuar sektori privat, i cili ka shumë më tepër arsye për të besuar se, qoftë në treguesit e pagave, ashtu dhe të produktivitetit, paraqitet i ndryshëm nga ai i sektorit shtetëror. Dhe më tej, analizat e produktivitetit bazohen vetëm në sektorët e industrisë, duke lënë jashtë sektorët e tjerë, të cilët në shumë raste, përfaqësojnë inpute për këtë sektor. Për rrjedhojë, analiza mbetet e mangët dhe jo e thelluar.

Nga këto të meta, mendojmë se dhe përfundimet e arritura duhen lexuar dhe interpretuar me rezerva.

II A JANË BËRË TREGJET E PRODUKTEVE SHQIPTARE MË TË INTEGRUARA SI REZULTAT I LIBERALIZIMIT?

1. RËNDËSIA E TREGTISË SË JASHTME PËR EKONOMINË KOMBËTARE.

Kuptimi i kësaj lidhjeje është i rëndësishëm për të vlerësuar luhatjet e brendshme makroekonomike si pasojë e ndryshimeve në konjukturën ndërkombëtare.

Mënyra që përdor literatura për të matur fuqizimin e lidhjeve ekonomike me botën është matja e pjesës së tregtisë së jashtme në aktivitetin ekonomik të vendit. Një nivel i lartë shkëmbimesh është tregues i një ekonomie të hapur, me lidhje të fuqishme me ekonominë botërore. Tabela në vijim paraqet këtë tregues për Shqipërinë dhe disa vende të tjera të Ballkanit si dhe për disa nga ekonomitë e zhvilluara, por të konsideruara si të vogla.

Tabela 2. Shkalla e hapjes ndaj tregtisë ndërkombëtare: pjesa e tregtisë së jashtme (importi + eksporti i mallrave), në përqindje të PBB-së.

	1993	1994	1995	1996	1997	1998	1999
Shqipëria	58	38	35.7	43.7	37.1	33.5	32.9

Për disa nga vendet e rajonit dhe vendet e zhvilluara të BE-së, me ekonomi të përmasave të vogla, treguesi i mësipërm paraqitet si më poshtë:

	1998
Bosnjë Herzegovina	70.2
Bullgaria	73.3
Maqedonia	85.7
Rumania	51.6
Ish-Jugosllavia	57.9
Ballkani Jugor	*58.9*
Irlanda	171.6
Belgjika	139.7
Hollanda	108.7



Grafiku 4. Tregtia e jashtme ndaj PBB, në përqindje.

Evidencat provojnë se në ekonomitë e vogla me të ardhura të larta (siç është rasti i Irlandës, Belgjikës, Hollandës) aktiviteti i tregtisë së jashtme është më i madh se prodhimi i brendshëm kombëtar.

Treguesit e mësipërm shprehin faktin se ekonomitë e vendeve të Ballkanit janë akoma të mbyllura ndaj ekonomisë botërore dhe Shqipëria është vendi më i mbyllur krahasuar me të gjitha vendet e tjera. Ky nivel i ulët i hapjes është i pasuportueshëm dhe ai nuk mund të çojë në rritje të lartë ekonomike [2]. Nxitja e zhvillimit të bazës së eksporteve do të çonte në një rritje të treguesit deri në të paktën nivelin e vendeve të tjera të rajonit. Rritja duhet të vijë kryesisht nga eksporti pasi vendi duhet të synojë një rritje të balancuar të sektorit të jashtëm të ekonomisë (deficitit tregtar).

Treguesi i hapjes së ekonomisë në periudhën 1980-90, duket të ketë qenë relativisht i njëjtë me periudhën tranzitore, duke përbërë 32.7 për qind të Prodhimit të Përgjithshëm Kombëtar. Por, dallimi i ndikimeve të eksternaliteteve është cilësor. Në sistemin e mëparshëm, ekonomia nuk

[2] Evidencat empirike provojnë se midis rritjes ekonomike dhe shkallës së hapjes së ekonomisë ekziston një lidhje e fortë. Ekonomitë që kanë një shkallë hapjeje më të lartë dhe janë më të integruara me ekonominë botërore kanë shënuar rritje më të shpejtë ekonomike. Shih. Athanasios Vamvakidis, "Regional Trade Agreements or Broader Liberalization: Which Path leads to Faster Growth?", IMF Staff Papers, Vol. 46. Nr.1, March 1999; Andrew Rose "One money, one market: Estimating the effect of common currencies on trade", NBER Working Paper 7432, December 1999.

dallonte cikle biznesi, shkëmbimet ishin kryesisht mall-mall, e për rrjedhojë, paraja nuk luante rolin që ajo merr sot.

Për më tepër, në atë periudhë nuk mund të flitet për politika monetare (të tilla si kursi i këmbimit të monedhës, etj.) e fiskale. Ndërsa dalja në tregun e mirëfilltë të tregtisë së jashtme, ku paraja dhe malli luajnë rol, ku performancat e ndërmarrjeve ndikohen nga luhatjet e cikleve të biznesit në vendet e ndryshme, bën që dhe roli i tregtisë së jashtme në shëndetin e firmave të vendit që punojnë me tregjet e huaja, qoftë si burime furnizimi apo si tregje shitjeje dhe, për rrjedhojë, dhe në shëndetin e ekonomisë kombëtare, të marrë një konsiderim të posaçëm.

Rritja e treguesit të hapjes së ekonomisë, megjithë nivelin modest të tij, shpreh rritjen e rëndësisë së tregtisë ndërkombëtare për ekonominë kombëtare. Për rrjedhojë dhe analiza e rolit të ndikimit të tregtisë në fluktacionet ekonomike, paraqitet e një rëndësie të veçantë. Megjithëse shkalla e hapjes së ekonomisë së vendit tonë në raport me vendet e tjera të Ballkanit jugor paraqitet në nivelin më të ulët, shkalla e koncentrimit të tregtisë së jashtme me vendet e BE-së paraqitet ndër më të lartat. Për rrjedhojë zhvillimet në BE paraqiten të rëndësishme dhe më influencuese në ecurinë e ekonomisë së vendit tonë.

2. LUHATSHËRMIA E VARIABLAVE TË TREGTISË.

Në analizën e kësaj çështjeje, ne i jemi përmbajtur treguesve statistikorë të përdorur nga autorët Eswar S. Prasad dhe Jeffery A. Gamble. Për matjen e luhatshmërisë të variablave të tregtisë së jashtme, kemi shqyrtuar devijimet standarde[3] të volumeve të mallrave të tregtisë së jashtme në lidhje me ciklet e biznesit[4]. Niveli i PBB-së (në dollarë amerikanë) volumet e eksportit dhe importit të mallrave dhe kursi real efektiv i këmbimit (reer) janë kthyer në

[3] Koeficienti i luhatshmërisë (*volatility*) është matur me devijimet standarde të parametrave të analizuar. Por i njëjti rezultat del dhe nga llogaritja e koeficientit të variacionit (si raport i devijimit standard me mesataren e treguesit). Koeficienti interpretohet si përqindje e ndryshimit të variablit në shqyrtim ndaj nivelit të tij mesatar.
[4] Të gjithë variablat janë përpunuar nga seritë e të dhënave tremujore, në programin E-vieës 3. Burimi i të dhënave: Banka e Shqipërisë.

logaritme. Variablat e tregtisë (vlera e eksportit dhe importit) shprehen në përqindje të PBB-së[5].

Devijimet standarde të kursit të këmbimit (Logreer), PBB-së (Loggdp), eksporteve (Expgdp) dhe importeve (Impgdp), kërkesës efektive të huaj (që është diferenca e PBB-së së Shqipërisë më PBB-në e Italisë, në logaritme) (LGDP_I) dhe kërkesës së huaj (Y), paraqiten si më poshtë (si raporte të devijimit standard të treguesit përkatës me devijimin standard të PBB-së, me përjashtim të devijimit standard të PBB-së):

Tabela 3. Devijimet standarde të variableve.

Loggdp	0.217
Logreer	0.529
Expgdp	6.147
impgdp	21.096
LGDP_I	0.695
Y	0.410



Grafiku 5. Luhatjet tremujore në ritmet e ndryshimit të importeve dhe eksporteve.

Siç shihet dhe në grafik dhe nga treguesi i devijimit standard, eksportet paraqesin një shkallë të lartë luhatshmërie në raport me PBB-në (me një devijim standard prej 6.147). Ndërsa importet paraqiten mbi tre herë më të luhatshme se eksportet në raport me PBB-në (me një devijim standard 21.096).

[5] Raporti i variablave të tregtisë ndaj PBB-së është një numër i vogël. Prandaj, luhatjet e këtij raporti, që numerikisht mund të dalë dhe i ngjashëm me përqindjen e devijimit standard të PBB-së, dëshmon një luhatshmëri më të madhe se luhatshmëria e vetë PBB-së.

Ndërsa luhatshmëria e çmimeve relative (Logreer) paraqitet dukshëm më e ulët se ai i treguesve të tregtisë së jashtme. Kjo mund të konsiderohet si dëshmi e faktit se kursi i këmbimit paraqitet pak i rëndësishëm[6] si instrument, që mund të ndikojë në përmirësimin e treguesve të tregtisë së jashtme.

Ndërkohë, luhatshmëria e prodhimit në vendet partnere dhe kërkesa efektive e jashtme, paraqiten më të ulëta se luhatshmëria e prodhimit të brendshëm. (Luhatshmëria e prodhimit relativ shpreh një tregues të përafërt të rolit dhe të rëndësisë së një '*shoku'* të ekonomisë së vendeve partnere (në rastin konkret vetëm të ekonomisë italiane) ndaj ekonomisë kombëtare.)

Ajo çfarë mund të konkludohet shkurtimisht nga kjo analizë është se luhatshmëria e importit paraqitet shumë më e rëndësishme për prodhimin e brendshëm (pra dhe për stimulimin e rritjes ekonomike) se çdo tregues tjetër influencues i mjedisit ndërkombëtar. Eksportet janë, gjithashtu, të rëndësishme si faktori i dytë bazë influencues.

Duke parë lidhjet që rezultojnë midis treguesve të tregtisë së jashtme dhe PBB-së, evidentohen këto fakte:

Nga paraqitja grafike e ndërvarësisë ndërmjet treguesve të PBB-së, eksporteve dhe importeve, evidentohet lidhja lineare që ekziston ndërmjet tyre. Efektet e importeve dhe të eksporteve mbi PBB-në janë gati të të njëjtës rëndësi (0.736 dhe 0.764). Ndikimi i tyre më i madh jepet brenda të njëjtës periudhë (tremujore) dhe zbehet ndjeshëm brenda një viti (duke rënë në 0.2).

Fakt tjetër i rëndësishëm nga matrica e korrelacioneve është dhe lidhja e ngushtë pozitive midis importeve dhe eksporteve (0.645). Lidhja është shumë e fortë brenda të njëjtës periudhë dhe dobësohet mjaft brenda një viti (me koeficient 0.1). Kjo mund të dëshmojë faktin se importet janë kryesisht inpute

[6] Paefektshmëria e përdorimit të kurseve të këmbimit për të ndikuar në sjelljen e eksportit dhe të deficitit tregtar është analizuar dhe nga autorë të tjerë: shih. Mançellari, Mytkolli, Kola, 1999, "Kurset e Këmbimit dhe Tranzicioni Ekonomik", f. 36. Megjithatë, vetë treguesi i kursit real efektiv të këmbimit (seri e marrë nga llogaritjet e bëra nga G. Kolasi dhe A. Tanku, Departamenti Kërkimeve i Bankës së Shqipërisë), duket i dyshueshëm, përderisa i llogaritur mbi treguesin e inflacionit, ai nuk mban në konsideratë diferencat në përbërjen e shportave të mallrave të përfshira në ndërtimin e indeksit të çmimeve të mallrave me vendet partnere të marra në konsideratë.

të përpunimit për produktet e eksportit. E shprehur ndryshe, kjo do të thotë se baza e ekonomisë së eksportit është kryesisht e mbështetur në përpunimin e lëndëve të importit.

Ndërkohë, lidhja midis eksporteve shqiptare dhe kërkesës së huaj (importeve italiane [impgdp_i] dhe ciklit të biznesit të Italisë [lgdp_i]) paraqitet dukshëm më pak e rëndësishme, duke reflektuar faktin se ecuria e eksporteve tona nuk influencohet nga kërkesa e huaj.

Shqyrtuam dhe normën e interesit [LOGI] (të Italisë, tremujore, duke gjykuar se tregtia është një transaksion afatshkurtër) për të parë nëse tregtia me Italinë është e ndikueshme nga kushtet e financimit. Rezulton se tregtia nuk është influencuar as nga ky variabël.

Siç shihet nga të dhënat e paraqitura në tabelë, lidhja më e fortë ekziston vetëm me importet italiane (0.335), megjithatë, treguesi nuk është statistikisht i rëndësishëm. Po kështu, cikli i biznesit në Itali dhe normat e interesit nuk dëshmojnë të kenë lidhje me variablat e tregtisë së vendit tonë.

Në mënyrë të përgjithshme, mund të thuhet se aftësia e tregtisë së jashtme për të gjeneruar shërimin ekonomik paraqitet e kufizuar. Për të analizuar dhe më tej këtë çështje, kemi matur edhe treguesin e kontributit të bilancit tregtar në rritjen ekonomike. Sipas llogaritjeve të bëra bazuar në formulën[7] e dhënë, del se kontributi i saj ka qenë i papërfillshëm (0.008). Ndërkohë që lidhja ndërmjet bilancit të llogarisë korente (në përqindje të PBB-së) me rritjen ekonomike paraqitet më e fortë (0.55), duke nënkuptuar që rritja ekonomike është ndikuar më shumë nga transfertat qeveritare dhe private (kryesisht të ardhurat nga emigracioni dhe transfertat qeveritare) se sa nga aktiviteti tregtar.

---

[7]

$$CB(j) = \frac{TB(t+j)-TB(t)}{Y(t)}$$

Ku CB(j) shpreh kontributin e rritjes së prodhimit në periudhën j; TB(t) shpreh bilancin tregtar në kohën t dhe Y(t) shpreh treguesin e PPB-së në kohën t. Llogaritjet janë bërë me një diferencë kohore prej një viti.
Shih: Prassard & Gable (1998) “International Evidence on the Determinants of Trade Dynamics” IMF Staff Papers, Vol.45, No.3.

	LOGGDP	LOGREER	EXPGDP	IMPGDP	LGDP_I	Y
Mean	6.493049	4.747381	7.602764	28.86285	13.07799	-6.584936
Median	6.470976	4.729993	7.402833	27.98907	13.08318	-6.604150
Maximum	6.879150	4.978150	10.42097	40.05536	13.20114	-6.321985
Minimum	6.075225	4.557493	5.533606	20.77585	12.90970	-6.883627
Std. Dev.	0.217176	0.115059	1.334485	4.578278	0.089531	0.151417
Skewness	0.166173	0.525356	0.211753	0.623177	-0.450257	-0.012778
Kurtosis	2.331518	2.445570	2.036270	3.256150	1.990457	2.529815
Jarque-Bera	0.557321	1.411389	1.108134	1.619011	1.830103	0.221728
Probability	0.756797	0.493766	0.574608	0.445078	0.400496	0.895061
Observations	24	24	24	24	24	24

	GDPUSD3_A	EKS3_A	EKS5	IMP3_A	IMP5
GDPUSD3_A	1.000000	0.764499	0.374340	0.736047	0.407543
EKS3_A	0.764499	1.000000	0.271028	0.645469	0.231067
EKS5	0.374340	0.271028	1.000000	0.460379	0.655929
IMP3_A	0.736047	0.645469	0.460379	1.000000	0.473704
IMP5	0.407543	0.231067	0.655929	0.473704	1.000000

	EXPGDP	IMPGDP_I	LGDP_I	LOGI
EXPGDP	1.000000	0.335428	-0.088325	0.046912
IMPGDP_I	0.335428	1.000000	0.111785	-0.174429
LGDP_I	-0.088325	0.111785	1.000000	-0.793050
LOGI	0.046912	-0.174429	-0.793050	1.000000

III PSE EKSPORTET?

Ndoshta faktori më i rëndësishëm që thekson nevojën e një ekonomie me orientim eksporti, përveç përfitimeve që realizohen nga rritja e eficiencës dhe e produktivitetit, është nevoja për të kapërcyer kufizimet e bilancit të pagesave. Për rindërtimin e kapaciteteve industriale dhe fuqizimin konkurrencial, vendi duhet të importojë volume të konsiderueshme kapitalesh dhe mallrash të ndërmjetme. Financimi i importeve të tilla përbën një kufizim serioz për procesin e riindustrializimit nëse nuk gjenerohen të ardhura suplementare nga aktiviteti i eksportit.

Megjithëse varësia në importimin e teknologjisë është më e madhe në etapat fillestare të industrializimit, ajo do të vazhdojë të jetë e pranishme gjatë gjithë procesit të zhvillimit ekonomik, si pjesë e procesit *'catching up'* me ekonomitë e zhvilluara dhe e avancimit teknologjik.

Në një ekonomi pa një industri të prodhimit të mallrave kapitale, siç është ekonomia shqiptare, si investimet dhe kursimet varen nga eksportet. Investimet do të varen në shkallën që importet e mallrave kapitale do të kërkojnë të ardhura nga eksportet[8].

Këto konsiderata sugjerojnë se, që rritja të jetë e qëndrueshme, zgjerimi i eksporteve është një domosdoshmëri. Edhe në treguesin e hapjes së ekonomisë shqiptare ndaj ekonomisë botërore, kontributi është thuajse tërësisht i importeve. Kështu, nëse raporti i eksporteve ndaj PBB-së është luhatur gjatë gjithë periudhës në kufijtë 5-8 për qind, ai i importeve varion nga rreth 50 për qind në fillimet e vitit 1993, për t'u stabilizuar në vitet në vazhdim në nivelet prej 25-30 për qind. Kjo shpreh faktin se lidhja e ekonomisë shqiptare me tregjet e huaja është kryesisht e njëanshme: ajo është e hapur ndaj importeve të huaja por eksportet e saj në tregjet botërore janë të panjohura.

[8] Në fakt, eksportet nuk janë i vetmi mjet i financimit të importeve të tilla. Remitancat nga jashtë ose hyrjet e kapitaleve të huaja janë, gjithashtu, burime të valutës së huaj. Megjithatë, ato nuk mund të vazhdojnë pafundësisht pasi në një periudhë jo të gjatë, ato bëhen pengesë për bilancin e pagesave.

Në grafin e mëposhtëm bie në sy shkalla e treguesit (diferenca në grafin e eksporteve në raport me PBB-në është me dy njësi, ndërsa në atë të importit është me dhjetë njësi).



Grafiku 6. Dinamika e tregtisë së jashtme të Shqipërisë në raport me PBB, në %.

Nga ana tjetër, vetë struktura e eksporteve ofron evidencë të mjaftueshme të faktit se rritja e eksporteve ka ndodhur në kontekstin e një *specializimi të ngushtë të tregtisë* brenda grupeve të ndryshme të produkteve. Pjesa kryesore që zënë 'produktet tekstile, veshje dhe lëkurë' në portofolin e eksporteve tregon që edhe investimet e huaja kanë qenë më tepër *'trade–complementing'* se sa *'trade–substituting'*.

1. NDRYSHIMET STRUKTURORE TË EKSPORTEVE SHQIPTARE GJATË PERIUDHËS 1996-'99.

Nisur nga klasifikimi i mallrave sipas SITC, grupmalli *mallra të tjera të përpunuara* mbetet dominues në eksporte, duke e rritur me 18 pikë përqindje peshën e tij ndaj totalit. Gjithashtu, me 4 pikë përqindje rritje shfaqet grupmalli

makineri dhe pajisje. Ndërkohë që, kanë humbur në peshë *mallra të përpunuara, lëndë djegëse dhe materiale të papërpunuara.*

Nëse do të ndaleshim në specializimin e eksporteve brenda grupmallrave, ndryshimet strukturore do të vlerësoheshin relativisht të larta. Megjithatë, llojshmëria e grupmallrave, brenda grupeve përfaqësuese në eksporte mbetet e ulët.

Grupmalli *ushqime dhe kafshë të gjalla* i përfaqësuar kryesisht nga eksporte peshku dhe zarzavatesh në vitin '96, përgjatë vitit '99 vëllimin më të madh në eksportin e këtij grupi e zunë *përgatitjet ushqimore prej mishi dhe peshku.* I ardhur nga industria e përpunimit në vend, ky grupmall e ka rritur me rreth 36 pikë përqindjeje vëllimin në total. Ndërkohë që, ka rënë ndjeshëm pesha ndaj totalit në eksportet e peshkut dhe të zarzavateve.

Materiale të papërpunuara edhe pse përfshijnë 8 grupmallra, në eksporte mbeten të specializuar në eksportin e farërave vajore (kryesisht bimë medicinale) dhe xeheror.

Ndër *produktet kimike* mungojnë eksportet në plehërues, të cilët në vitin '96 përfaqësonin grupmallin kryesor të grupit me rreth 34 për qind. Plastika dhe artikuj zënë vëllimin më të madh të eksporteve të grupit për vitin '99, si dhe shfaqen me tendenca në rritje eksportet në preparate larëse.

Mallra të përpunuara, grupi me llojshmërinë më të lartë të grupmallrave (32 grupmallra), në një total rreth 90 për qind përgjatë vitit '99 përfaqësohet nga 9 grupmallra. Në rritje qëndrojnë eksportet e drurit, artikuj metali (eksporte totalisht nga fusha e përpunimit aktiv) si dhe plumbi dhe artikujt e tij. Rënia ka qenë më e madhe në eksportet e gizë e çelik (kryesisht ferrokrom) dhe bakër, e cila ndikoi në masën më të madhe në rënie të eksportit të këtij grupi duke zvogëluar njëkohësisht edhe peshën e tij në 12 për qind nga 19 për qind e totalit të eksporteve në vitin '96.

Mallra të tjerë të përpunuar, grup përfaqësues i eksporteve tona me mëse 64 për qind të totalit të përgjithshëm, edhe pse i përbërë nga 18 grupmallra,

mbetet i specializuar në eksportin e artikujve të veshjes (të thurura e të pathurura) si dhe në veshjet e këmbëve.

Tabela 4. Pesha specifike e 10 grupmallrave në totalin e eksporteve, në %.

Kodi	Përshkrimi	1996	1999
0	Ushqime dhe kafshë të gjalla	4	4
1	Pije dhe duhan	4	3
2	Materiale të papërpunuara	12	7
3	Lëndë djegëse	11	3
4	Yndyrna bimore dhe shtazore	2	0
5	Produkte kimike	2	1
6	Mallra të përpunuara	19	12
7	Makineri dhe pajisje	2	6
8	Mallra të tjera të përpunuara	46	64
9	Mallra të paklasifikuara diku tjetër	0	0
	TOTAL	**100**	**100**

2. SHKALLA E SPECIALIZIMIT TË EKSPORTEVE.

Indeksi që përdoret për matjen e shkallës në të cilën eksportet e një vendi janë të diversifikuara midis (ose të koncentruara në) nivelit SITC treshifror të klasifikimit të mallrave është *'indeksi i përqëndrimit të eksporteve*[9]*'*. Është interesante të shohim këtë tregues për vendin tonë dhe disa vende të tjera:

Tabela 5. Indeksi i përqëndrimit të eksporteve.

Vendet	Viti 1992
Turqi	0.119
Kroaci	0.108
Greqi	0.118
Itali	0.056
Gjermani	0.084
Shqipëri[10]	0.562

Treguesi i mësipërm, shpreh faktin se eksportet shqiptare janë të përqëndruara vetëm në dy grupe mallrash, gjë që sjell nevojën për themelimin e një ndërveprimi dinamik ndërmjet eksporteve dhe investimeve në procesin e industrializimit.

[9] Indeksi është llogaritur duke përdorur metodologjinë e Hirschman ose Herfindahl: merret shuma e katrorëve të përqindjes së eksporteve për çdo grup malli sipas klasifikimit SITC; indeksi llogaritet si rrënja katrore e shumës, e normalizuar ndërmjet shifrave një (koncentrimi maksimal) dhe zero. World bank report: From plan to market, 1996).

[10] Indeksi për vendet e paraqitura në tabelë është marrë "From Plan to Market"; World Development Report, 1996, published by the World Bank. Treguesi për Shqipërinë i referohet të dhënave të vitit 1996 dhe është llogaritur sipas të njëjtës metodologji; llogaritjet tona.

Përpunimi për eksport (Outward processing trade - OPT) në ekonominë shqiptare është shumë i lartë krahasuar me ekonomitë e tjera të rajonit. Eksportet e OPT llogariten[11] për 30 për qind të totalit të eksporteve për Rumaninë, 15 për qind për Bullgarinë dhe vetëm 11 deri në 13 për qind për vendet e tjera të Europës Qendrore dhe Lindore.

Shkalla e ulët e specializimit të eksporteve, bën që ato të jenë më të ndjeshme ndaj lëvizjeve në konjukturën e çmimeve në tregjet ndërkombëtare. Përsëri, të dhënat tregtojnë se çmimet e eksporteve kanë qenë më të ndjeshme se ato të importeve[12]. Përsëri ne kemi matur devijimet standarde të çmimeve, ku rezulton se devijimi standard i çmimeve të eksportit (0.0921) është rreth 0.32 herë më i lartë se devijimi standard i çmimeve të importeve (0.0699).

Duke analizuar më tej dinamikën e çmimeve të tregtisë së jashtme, vërejmë se termat e tregtisë janë përkeqësuar me 9.6 për qind brenda një periudhe gati trevjeçare, ose me rreth 3 për qind në vit. Luhatshmëria më e lartë i çmimeve të eksporteve na bën të mendojmë se burimi i përkeqësimit të termave tregtarë qëndron më tepër në faktin se në origjinën e eksporteve tona qëndrojnë më tepër mallrat që janë të ndjeshme ndaj çmimeve.

Në përfundim, ritheksojmë se themelimi i ndërveprimit dinamik midis tregtisë së jashtme dhe procesit të investimeve, është i rëndësishëm që të rikonsiderohet me objektiva: rritjen e shkallës së diversifikimit të produkteve; fokusimit në produktet që ndodhen në një shkallë më dinamike në ciklin e jetës së tyre (për të shmangur luhatshmërinë e lartë të çmimeve të eksportit) dhe arritjen e një pozicioni më të ekuilibruar në pjesën e tregut të importeve dhe eksporteve.

[11] Barry Eichengreen and Richard Kohl, 1998 “The External Sector, the State and Development in Eastern Europe” BRIE Working Paper 125.

[12] Llogaritjet bazohen në të dhënat mbi çmimet njësi të importit dhe të eksportit të ofruara nga INSTAT (të dhëna që nuk janë akoma për përdorim publik). Llogaritjet bazohen në të dhënat tre mujore për periudhën tremujori parë i vitit 1997 deri në tremujorin e parë të vitit 2000 (me bazë vitin 1996).

IV KONKURRENCIALITETI I JASHTËM I EKONOMISË: PAGAT DHE PRODUKTIVITETI

Procesi investues, si elementi që pritet të sigurojë balancimet e nevojshme në zhvillimet e tregtisë së jashtme, do të kërkonte një analizë të shkallës së konkurrencialitetit të parametrave ekonomikë, që ndikojnë marrjen e vendimeve për vendosjen e një projekti të dhënë.

Në qendër të debatit të sotëm të kritikave ndaj globalizimit në rritje të ekonomisë botërore, janë vënë disnivelet e pagave dhe roli i këtij faktori në rialokimin e investimeve drejt vendeve në zhvillim. Vendet e zhvilluara gjithnjë e më shumë po frikësohen se vendet me paga të ulëta po ndikojnë mirëqenien e punëtorëve të vendeve të tyre. Kjo për shkak të rialokimit të investimeve nga këto vende drejt vendeve me fuqi punëtore më të lirë.

Propogandimi i faktit se pagat më të ulëta në vendin tonë janë një avantazh konkurrencial ndaj vendeve të tjera të rajonit, promovohet shpesh dhe në median e vendit tonë. Kjo na ngacmoi për të hedhur pak më shumë dritë mbi këtë çështje.

Pyetja e parë që shtrohet është: a janë në të vërtetë diferencat e pagës burim i konkurrencialitetit dhe në çfarë pozicioni qëndron vendi ynë në raport me konkurrentët tanë kryesorë? Teorikisht, pagat e ulëta reflektojnë nivele të ulëta të produktivitetit. Një përpjekje është bërë për të vlerësuar konkurrencialitetin e jashtëm në elementet e kostos[13], duke shqyrtuar disa tregues të tregut të punes.

Duke shqyrtuar treguesit e kostos së fuqisë punëtore, vendi ynë prezanton nivelet më të ulëta të pagave kundrejt vendeve të tjera në tranzicion, rreth 13 për qind më të ulëta se Bullgaria (vendi me pagat më të ulëta në grupin

[13] Duhet theksuar se ekzitojnë kufizime të rëndësishme të të dhënave, e për rrjedhojë, rezultatet nuk mund të konsiderohen me një shkallë të lartë saktësie. Kufizimi i parë janë të dhënat e kufizuara dhe saktësia e të dhënave statistikore të publikuara. Së dyti, të dhënat kryesisht i referohen aktiviteteve prodhuese ose industriale, e cila nuk merr në konsideratë kostot e faktorëve në sektorët e tjerë, të cilat zënë një pjesë të caktuar në koston e industrisë si inpute të prodhimit industrial. Analiza bëhet më komplekse në rastin e inputeve të huaja të cilat, gjithashtu, zënë një pjesë të konsiderueshme në prodhimin e firmave të vendit.

krahasues). Në të njëjtën kohë, pagat reale janë rritur me një mesatare të njëjtë vjetore prej rreth 20 për qind për të gjitha vendet në analizë.

Tabela 6. Shqipëria: Tregues të konkurrencialitetit.

	1992	1993	1994	1995	1996	1997	1998
Prodhimi industrial, mil.lek	14,853	21,268.2	20,693.8	25,728.7	27,864.3	24,112.3	24142.8
Kursi këmbimit,USD, mes. Periudh.	75	102	95	93	104.5	149.1	150.64
Prodhimi industrial (Mil. USD)	198.0	208.3	218.5	277.2	266.6	161.7	160.3
Punësimi në industri	122,830	93,948	42,912	40,539	36,330	40,540	42,896
Prodhimi për punëtor (*produktiviteti),* në USD	1,612	2,217	5,092.3	6,839.1	7,339.5	3,989.1	3,736.2
Ndryshimi produktivitetit, %		38	130	25.5	6.8	-84.0	-6.8
Paga mesatare, sek. shtetërore, lek	1,761	3,220	5,260	7,216	9654	9820	11932
Ndryshimi pagës reale, në %		34.3	76.1	40.0	18.8	-28.7	20.3
Paga mesatare në, USD	23.5	31.5	55.5	77.8	92.4	65.9	79.2
Kosto për njësi pune, në USD	69	70	92	88	79	61	47
Ndryshimi i kostos së punës, në %		2	30	-4	-11	-31	-28

Llogaritjet janë bazuar në të dhënat e marra nga statistikat e Ministrisë së Ekonomisë dhe Privatizimit, Treguesit Kryesorë për vitet 1992-1998, qershor, 1999. Llogaritjet janë tonat.



Grafiku 7. Produktiviteti dhe kostot.

Megjithëse pagat e ulëta janë një element konkurrence, në thelb është treguesi i produktivitetit ai që përcakton ndjeshëm tërheqshmërinë e një vendi.

Nga të dhënat e tabelës, rezulton se rritja e produktivitetit të sektorit shtetëror të ekonomisë ishte e ndjeshme në periudhën 1994-1996, duke rënë në dy vitet në vazhdim gati në nivelin e vitit 1993. Më tej, kostoja e punës nuk zë veçse një fraksion të vogël në shpenzimet e një firme (19.5 për qind të totalit të shpenzimeve në sektorin e industrisë [14]). Për rrjedhojë, konkurrencialiteti duhet të kërkohet në të gjitha elementet që prezantohen në strukturën e shpenzimeve të një firme apo të një sektori të ekonomisë.

Blerja e teknologjisë së re dhe kapitalit, gjatë kësaj periudhe, është shoqëruar me rritjen e produktivitetit, e për rrjedhojë, edhe të cakut konkurrencial. Megjithatë, do të vazhdojnë të veprojnë edhe faktorë kundërbalancues:

* Rritja e produktivitetit do të sjellë rritjen e pagave, e cila nga ana e saj e ul cakun e konkurrencës.

* Niveli i ulët i kapitalit njerëzor (know-how) si dhe infrastruktura e dobët publike dhe e shërbimeve të transportit, do të tentojnë të ulin produktivitetin.

Kjo na çon në konkluzionin se vetëm në produktet ose në proceset e prodhimit të cilat nuk kanë nevojë për kapital njerëzor shumë të kualifikuar, vendi do të mund të zotërojë një cak të caktuar konkurrencialiteti.

[14] INSTAT, Rezultatet e anketës strukturore të ndërmarrjeve ekonomike, 1998; Tiranë, qershor, 2000.

KONKLUZIONE

Materiali i mësipërm kishte tre objektiva: .

* Të jepte një shpjegim mbi kuptimin e lidhjeve midis aktivitetit të tregtisë së jashtme dhe ekonomisë kombëtare;

* Të hedhë dritë për shkallën e lidhjes dhe të varësisë së tregtisë së jashtme të vendit tonë me ekonomitë (ciklet e biznesit) e vendeve kryesore partnere.

* Të japë disa argumente shtesë për rëndësinë e eksporteve për ekonominë e vendit tonë dhe zhvillon në këtë drejtim një kuadër më të thelluar të shkallës së konkurrencialitetit të ekonomisë së vendit tonë në raport me ekonomitë e disa vendeve të tjera në tranzicion.

Nga shqyrtimi i treguesve të zgjedhur gjatë analizës, rezultojnë:

* Megjithëse shkalla e hapjes së ekonomisë së vendit tonë, në raport me vendet e tjera të Ballkanit jugor, paraqitet në nivelin më të ulët, shkalla e koncentrimit të tregtisë së jashtme me vendet e BE-së paraqitet ndër më të lartat. Për rrjedhojë, dhe performancat e saj mendohet se janë shumë të ndjeshme ndaj zhvillimeve në BE.

* Ajo çfarë mund të konkludohet nga analiza është se luhats hmëria e importit paraqitet shumë më e rëndësishme për prodhimin e brendshëm (pra dhe për stimulimin e rritjes ekonomike). Eksportet janë, gjithashtu, të rëndësishme si faktori i dytë bazë influencues.

* Ndërkohë, lidhja midis eksporteve dhe kërkesës së hu aj paraqitet dukshëm më pak e rëndësishme, duke reflektuar faktin se ecuria e eksporteve tona nuk influencohet nga kërkesa e huaj.

Në mënyrë të përgjithshme, mund të thuhet se aftësia e tregtisë së jashtme për të gjeneruar shërimin ekonomik, paraqitet e kufizuar.

Shkalla e ulët e diversifikimit të portofolit të produkteve të eksportit, ofron evidenca të mjaftueshme për të nxjerrë në pah rolin dhe rëndësinë që paraqesin përpjekjet për diversifikimin e tij. Ndërveprimi dinamik midis procesit investues dhe zgjerimit të bazës së eksporteve është i një rëndësie parësore.

Duke parë treguesit e shkallës së konkurrencialitetit të jashtëm të ekonomisë, të matur me disa tregues të tregut të punës, duket se vendi ynë akoma gëzon një pozicion disi të favorshëm. Megjithatë, nxjerrja e përfitimeve maksimale prej saj paraqitet e kufizuar në kohë.

Kjo na çon në konkluzionin se vetëm në produktet ose proceset e prodhimit të cilat nuk kanë nevojë për kapital njerëzor shumë të kualifikuar, vendi do të mund të zotërojë një cak të caktuar konkurrencial.

BIBLIOGRAFIA

Andrew Rose “One money, one market: Estimating the effect of common currencies on trade”, NBER Working Paper 7432, December 1999.

Athanasios Vamvakidis, “Regional Trade Agreements or Broader Liberalization: Which Path leads to Faster Growth?”, IMF Staff Papers, Vol. 46. Nr.1, March 1999;

Barry Eichengreen and Richard Kohl, 1998 “The External Sector, the State and Development in Eastern Europe” BRIE Working Paper 125.

D. Greenaway, C. Milner, 1995 "The world trade system and the Uruguay Round", International Labour Review, vol. 134, nr. 4-5.

Mançellari, Mytkolli, Kola, 1999, “Kurset e Këmbimit dhe Tranzicioni Ekonomik”, f. 36.

Prassard & Gable (1998) “International Evidence on the Determinants of Trade Dynamics” IMF Staff Papers, Vol.45, No.3.

World Bank: World Development Report, 1996 “From Plan to Market”

INSTAT, Rezultatet e anketës strukturore të ndërmarrjeve ekonomike, 1998; Tiranë, qershor, 2000

Të dhëna nga botimet e Bankës së Shqipërisë dhe të Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.